

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK)

NJOFTIM PËR APLIKIMIN PËR LICENCË PËR INXHINIERËT NË FUSHËN E NDËRTIMIT

Në mbështetje të: nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, dhe nenit 26 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 8 dhe nenit 27, të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokolli 8648/24; dhe nenit 5, nenit 6, paragrafi 4, nenit 7 dhe nenit 8 të RREGULLORES PËR PROCEDURËN E LICENCIMIT, RILICENCIMIT, MIRËMBAJTJEN, PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS SË INXHINIERIT TË LICENCUAR TË ODËS, njoftojmë të gjithë inxhinierët se duke filluar nga data **12.05.2025** mund të aplikojnë për licencim në OIRK.

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

- Formulari për aplikim – Shtojca 1.
- Kopje e letërnjoftimit ose pasaportës.
- Fotografi (35x45 mm).
- Kopje e diplomës (ose kualifikimit akademik, përfshirë kreditë ECTS). Për kandidatët që kanë diplomuar jashtë vendit, kërkohet edhe vendimi i nostrifikimit nga MASHT-i.
- Dëshmi e përvojës profesionale, si kontrata pune apo referenca (referencat duhet të përshkruajnë saktësisht detyrat profesionale, adresën e emailit dhe numrin kontaktues të punëdhënësit). Dëshmitë mund të mbështeten edhe me raportin e Trustit Pensional, deklaratë të ATK-së ose ndonjë dokumentacion tjetër përkatës.
- Curriculum Vitae (CV).
- Deklarata e përgjegjësisë profesionale.

Aplikimi me dokumentacionin përkatës dorëzohet në formë fizike në arkivin e OIRK-së, deri në funksionalizimin e platformës për aplikim elektronik (e-licenca), drejtuar Komisionit të Odës së Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në adresë: Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr. 3, kati i 2-të, 10000 Prishtinë.

Për më shumë informacione, shkruani në adresën elektronike: odaexhinierëve@gmail.com